



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, dje u mbajt konferenca përgatitore për Prokurorinë, gjatë të cilës Trupi Gjykues u bëri pyetje palëve në lidhje me numrin e dëshmitarëve që Prokuroria synon të thërrasë, kohën që Prokuroria vlerëson se do t'i duhet për paraqitjen e provave të veta, statusin e nxjerrjes së materialit dhe një sërë pikash të tjera të lidhura me çështjen gjyqësore.

Gjithashtu, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër gojor për shtyrjen e deklaratave hyrëse në këtë çështje, sikurse u kërkua nga Mbrojtja. Gjykatësit urdhëruan që gjykimi të fillojë më 3 prill me deklaratat hyrëse, jo më 1 mars, siç ishte njoftuar më parë. Deklaratat hyrëse do të vazhdojnë më 4 dhe 5 prill të pasuara nga dëgjimi i dëshmitarëve më 11 prill. Data e synuar për mbylljen e paraqitjes së provave të Prokurorisë u caktua 1 prilli 2025.

Trupi Gjykues planifikoi gjithashtu një konferencë për ecurinë e çështjes në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë* për datën 20 mars, në orën 9:00.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, javën e kaluar Trupi Gjykues urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe ekipet e Mbrojtjes të rishikonin disa parashtime konfidenciale me synimin për t'i bërë ato publike nëse ishte e mundshme, së bashku me redaktimet e nevojshme. Në vendimin e vet, Trupi Gjykues theksoi parimin se proceset janë publike, përveç rasteve kur nevojiten redaktime, për shembull, për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Deklaratat hyrëse në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala* janë planifikuar për të martën dhe të mërkurën e ardhshme, më 21 dhe 22 shkurt, dhe fillojnë në orën 9:30 në të dyja ditët. Për të ndjekur seancën nga galeria për publikun nevojitet regjistrim paraprak. Afati i fundit për regjistrimin paraprak është sot. Më shumë informacion lidhur me këtë gjendet në faqen e internetit të DHSK-së. Seanca mund të ndiqet edhe përmes faqes së internetit të DHSK-së në shqipe, serbishte dhe anglishte, me 45 minuta vonesë.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 9 shkurt, Trupi Gjykues vendosi që procedura për zhdëmtim dhe procesi penal të zhvillohen njëkohësisht dhe se, në rast se do të ketë shpallje të fajësisë, Trupi Gjykues nuk do t'i referojë viktimat për padi civile në Kosovë. Në fakt, Trupi Gjykues do të lëshojë një urdhër për zhdëmtimet. Trupi Gjykues ka ndjekur të njëjtën praktikë për zhdëmtimet në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, sot u mbajt konferenca para apelit. Rregullorja përcakton thirrjen e një seance të tillë për t'i mundësuar personit të paraburgosur në pritje të apelit të ngrejë çështje, përfshirë edhe lidhur me gjendjen mendore dhe fizike të personit. Versioni i redaktuar publik i Njoftimit të Mbrojtjes për Apel tani është në faqen e internetit të DHSK-së.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**
N°6/2023
Hagë, 16/02/2023

Pyetje nga gazetarët
Nuk pati pyetje.

